



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

**Në çështjen juridike të:**

**AC-I-20-0046**

**M. (Sh) H** , Rahovec

***Paditësi/Ankuesi***

***Kundër:***

- 1. Komuna e Rahovecit.** ***Të paditurat***
- 2. NBI "R..",** përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani" nr.23** , Prishtinë.
- 3. B. F H**, Rahovec.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës të ankuesit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-13-0142 të datës 11 shkurt 2020, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 mars 2020, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1.** Ankesa e paditësit , refuzohet si e pabazuar.
- 2.** Vërtetohet, Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-III-13-0142 i datës 11 shkurt 2020.
- 3.** Nuk caktohet taksë në procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 28 mars 2002, paditësi ka dorëzuar një padi në Gjykatën Komunale në Rahovec për shkak të vërtetimit të pronësisë. Paditësi kishte pohuar se është pronar i parcelave të shënuara në listën e posedimit nr. 258 KK R.. të shënuara në emër të Komunës së Rahovecit, pronare e pronës shoqërore, NBI R.. kinse shfrytëzues e këtyre parcelave dhe i padituri i tretë si pronar dhe shfrytëzues i ngastrës në listës së posedimit nr. 54. Tutje paditësi kishte pohuar se pasi babai i tij kishte vdekur më 29.12.1974, ai është shpallur trashëgimtarë i tij në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Komunale të Rahovecit T.nr. 1/81 të datës 07.01.1981, dhe nëse të paditurit nuk i pranojnë këto fakte ai ka propozuar të merret në pyetje eksperti i Drejtorisë për kadastër dhe gjeodezi I. C K, si dhe nëse ka nevojë edhe dëshmitarë të tjerë. Paditësi ka pohuar se sipas të paditurve parcelat e cekura kanë kaluar në prona të tyre kinse në bazë të lutjes së babait të paditësit mbi faljen e këtyre parcelave me Aktvendimin e Kuvendit Komunal Rahovec nr. 3690/1 dt. 06.07.1964, si dhe me kontratën e pa nënshkruar as nga ana e paditësit as nga ana e përfaqësuesit të Komunës më 27.10.1964 nr. 05/3690/1. Kjo kontratë as nuk është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Rahovec. Paditësi pohon se të paditurit kurrë nuk kanë qenë pronar dhe posedues të parcelave, por në posedim dhe shfrytëzim të këtyre parcelave ka qenë babi i paditësit deri sa ka qenë gjallë, kurse pas tij deri më sot pa kurrfarë pengese të gjitha këto parcela i ka punuar dhe shfrytëzuar paditësi. Paditësi në padinë e tij ka kërkuar që të vërtetohet që paditësi është pronar i të gjitha parcelave siç vijon:

- Parcela nr 147 e quajtur "L.." arë kl.3 në sipërfaqe prej 0.06,46 ha
- Parcela nr 391 e quajtur "B.." vreshtë kl.3 në sipërfaqe prej 0.04,70 ha
- Parcela nr 1377 e quajtur "L.." arë kl.2 në sipërfaqe prej 0.11,38 ha
- Parcela nr 1588 e quajtur "S.." arë kl.2 në sipërfaqe prej 0.09,58 ha
- Parcela nr 1650 e quajtur "R.." arë kl.3 në sipërfaqe prej 0.01,84 ha
- Parcela nr 2044 e quajtur "L.." arë kl.4 në sipërfaqe prej 0.03,74 ha
- Parcela nr 2088 e quajtur "S.." arë kl.5 në sipërfaqe prej 0.08,71 ha
- Parcela nr 2195 e quajtur "B.." kullosë kl.3 në sipërfaqe prej 0.06,50 ha, të gjitha nga lista poseduese nr 258 e lëshuar më 11.02.2002 nën nr 08/453 në emër të paditurit të parë dhe të dytë, dhe

- Parcela nr 1672 e quajtur "R" arë kl.3 në sipërfaqe prej 0.12,56 ha nga lista poseduese nr 54 KK Rahovec në emër të paditurit të tretë nr. 08/453 dt. 11.02.2002,
- si dhe të obligohen të gjitha të paditurat të pranojnë dhe të lejojnë që të parcelat e cekura ti shënohen në Drejtori për kadastër dhe gjeodezi paditësit si pronar i tyre, si dhe të paguajnë shpenzimet procedurale.

Me datë 29 tetor 2003, Gjykata Komunale në Rahovec merr Aktvendim C.nr. 51/2002 me të cilin për shkak të vdekjes të paditurit të tretë B. H nga Rahoveci e ndërpre në procedurën.

Me datë 19 nëntor 2003, paditësi ka dorëzuar një parashtresë me të cilin ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv. Me këtë parashtresë paditës paraqiten përveç M. Sh H tani edhe H. Sh H si dhe S. Sh H ndërsa të paditur janë përveç tre të paditurve të parë tani edhe Gjyle B. H ,I. B H dhe M. F H

Me datë 04 prill 2007, Gjykata Komunale në Rahovec me Aktvendimin C.nr 288/03 me të cilin e ndërpre në procedurën për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të NBI "R.." në Rahovec.

Me datë 18 mars 2011, paditësi dorëzon një parashtresë në Gjykatën Komunale në Rahovec për vazhdimin e procedurës kontestimore dhe ndryshimin e legjitimitetit pasiv pasi trashëgimtar juridik i NBI "R.." është Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

Me datë 25 maj 2012, Gjykata Komunale në Rahovec me Aktvendimin C.nr. 283/2011 e ndërpre në procedurën për shkak të vdekjes së paditurës së tretë Gj. H.

Me datë 06 dhjetor 2012, paditësi dorëzon një parashtresë me të cilën i kërkon gjykatës që të vazhdoj procedurën me pasardhësit e të ndjerës Gj. H, F dhe I. H.

Me datë 17 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Rahovec me Aktvendimin C.nr 244/2012 shpallë inkompetencën lëndore dhe shkresat e lëndës i dërgon Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente.

Me datë 01 mars 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë i dërgon shkresat e lëndës në DHPGJS në kompetencë të mëtejme, dhe lënda merr numrin C-III-13-0142.

Me datë 06 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar lëshon Urdhër me të cilin padia e paditësit i dërgohet AKP-së për zë parashtuar mbrojtje në padi.

Me datë 22 nëntor 2013, AKP dorëzon në DHPGJS mbrojtjen në padi me të cilën kërkon nga DHPGJS-ja që të pezullohet procedura në shqyrtimin e padisë së paditësit në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033, dhe në rast se DHPGJS nuk e pezullon rastin atëherë kërkesëpadinë e paditësit për njohjen e të drejtës pronësore ta refuzon si të pabazuar në ligj. AKP në mbrojtjen e saj thekson se paditësi nuk ka bërë të qartë në padi se cilat ngastrat i kërkon nga NSH-ja dhe cilat nga personi fizik, si dhe duhet të dërgon edhe Aktvendimin nr. 3690/1 dt. 06.07.1964 të cilin e konteston si bazë të transferimit të ngastrave kadastrale tek Komuna e Rahovecit. AKP pohon se sa i përket kontratës të cilën e konteston paditësi mes paraardhësit të tij dhe Komunës së Rahovecit për transferimin juridiko pronësor të ndodhur më 1964, AKP e konsideron si të ligjshëm dhe të vlefshëm. AKP tutje pohon se edhe nëse supozohet fakti se prona e paraardhësit të paditësit pa bazë ligjore ka kaluar në pronësi shoqërore, Komuna dhe NSH-ja e ka fituar pa bazë të drejtën e pronësisë, në bazë të nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar i cili është i aplikueshëm në Kosovë (Gazeta Zyrtare RSFJ nr 53/76), në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë, parasheh afatet brenda të cilit duhet të ushtrohet një padi për kthimin e pronës, andaj edhe mbi këtë bazë kjo pronë do të mund të kishte kaluar dhe regjistruar në emër të NSH R..

Me datë 19 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS me Aktvendimin C-III-13-0142 e pezullon procedurën gjyqësore pasi që NSH "R.." është në likuidim, pasi që AKM-ja e kishte njoftuar DHPGJS se NSH "NBI R.." sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKM-së është në likuidim në fakt që nga data 29 janar 2007.

Me datë 14 janar 2014, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) ka parashtuar në DHPGJS ankesë me të cilën e ankimon Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar

C-III-13-0142 të datës 19.12.2013, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesi i propozon Kolegjit të Apelit që të aprovoj ankesën e ankuesit, ta ndryshoj Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar dhe procedura gjyqësore të vazhdoj, ose të njëjtin ta prish dhe lëndën ta kthej për rigjykim.

Me datë 01 qershor 2017, AKP dorëzon përgjigjen në ankesë me të cilën në tërësi e kundërshton ankesën e ankuesit si të pabazuar në ligj. AKP pohon se e mbështet Aktvendimin ankimuar të Dhomës së Posaçme si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP thekson se ankuesi me ankesën e tij vetëm ka përsëritë kërkesë padinë e tij, dhe se pezullimi i procedurës parashihet shumë qartë mbi bazën e nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033. AKP kërkon nga Kolegji i Apelit që të refuzon ankesën e ankuesit si të bazuar dhe të vërteton Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS C-III-13-0142 dt. 19.12.2013.

Me datë 05 nëntor 2018, ankuesi ka dorëzuar në DHPGJS një kërkesë për masë të përkohshme me të cilën kërkon anulimin e shpalljes së ofertave dhe ndalimin e shitjes së parcelave që janë në kontest gjyqësor. Ankuesi pohon se AKP ka bërë shpalljen e asetëve në Likuidim-42, për shitjen e parcelave me numra: P-71510068-00174-0 në sipërfaqe 646 m<sup>2</sup> me kulturë arë e klasës së 3, P-71510068-02044-0 në sipërfaqe 374 m<sup>2</sup> me kulturë arë e klasës së 4, P-71510068-01377-0 në sipërfaqe 1138 m<sup>2</sup> me kulturë arë e klasës së 2, dhe P-71510068-01588-0 në sipërfaqe 958 m<sup>2</sup> me kulturë arë e klasës së 2, dhe unë M. H jam në kontest gjyqësor për këto parcela kadastrale që është shpallur oferta. Ankuesi ka pohuar se gjithashtu jam në kontest gjyqësor edhe për parcelat nr 391 në sipërfaqe prej 470 m<sup>2</sup>, nr 1650 në sipërfaqe prej 184 m<sup>2</sup>, nr 2088 në sipërfaqe prej 871 m<sup>2</sup>, dhe nr 2195 në sipërfaqe prej 650 m<sup>2</sup>, e që për këto parcela ende nuk janë shpallur ofertat. Ankuesi i ka propozuar gjykatës që pasi ekziston kontest gjyqësor lidhur me ngastrat e cekura të anulohet shpalljen e ofertave dhe të ndalojë shitjen për parcelat që janë cekur më lartë.

Me datë 10 tetor 2019, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-14-0011, ankesën e ankuesit e aprovon si të bazuar e anulon Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS C-III-13-0142 për pezullim të procedurës dhe lëndën ia kthen

shkallës së parë për gjykim si dhe kërkesën për caktimin e masës së sigurisë e refuzon si të pabazuar, me arsyetimin se e njëjta nuk i përmbushë kushtet e nenit 61 të LDHP-së për të caktuar masën e sigurisë.

Me datë 06 nëntor 2019, paditësi dorëzon edhe një kërkesë të dytë në DHPGJS për lëshimin e masës së sigurisë dhe anulimin e shpalljes së ofertave dhe ndalimin e shitjes së parcelave që janë në kontest gjyqësor. Paditësi edhe në këtë kërkesë për masë të sigurisë i kishte pohuar po të njëjtat pretendime sikurse në kërkesën paraprake për lëshimin e masës së sigurisë të dorëzuar në DHPGJS me datë 05 nëntor 2018. Kërkesës ia kishte bashkangjitur dy vërtetime.

Vërtetimin e lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjakovës –Dega Rahovec 797/2019 datë 13.02.2019 me të cilin shihet se në regjistër të Gjykatës nuk gjendet kontrata mbi faljes mes Sh. H dhe Komunës së Rahovecit dhe Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, e Komunës së Rahovecit 11-2019 datë 15.02.2019, me të cilin vërtetohet se në këtë Drejtori në arkiv është kontrata mbi faljen 05-3690/1 datë 27.10.1964 mes palëve të cekura por e pa nënshkruar.

Me datë 11 shkurt 2020, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-13-0142, e refuzon kërkesën e paditësit për lëshimin e masës së sigurisë. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka arsyetuar se pas shqyrtimit të provave të cilat ekzistojnë në dosje, asnjëherë ngastrat kadastrale të pretenduara nuk kanë kaluar në pronësi të paraardhësit të paditësit, por janë në emër të Komunës së Rahovecit dhe shfrytëzues i tyre është NB R...

Me datë 21 shkurt 2020 përmes postës paditësi (ankuesi) ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-III-13-0142 të datës 11.02.2020 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LDHP, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesi ka pohuar se Aktvendimi i cekur përmban shkelje ligjore dhe ka kundërthënie mes dispozitivit dhe arsyetimit ligjor, nuk është sjellë në bazë të provave të sjella etj. Ankesës nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë.

Me datë 28 shkurt 2020, AKP ka parashtruar përgjigjen ndaj kërkesë së ankuesit për lëshimin e masës së sigurisë ku mes tjerash ka pohuar se në tërësi e mbështet Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së. Tutje AKP ka pohuar se ankesa nuk i përmbushë kriteret e nenit 66 të Ligjit 06/L-0086 për DHPGJS-në. Kolegjit të Apelit i propozon që të refuzoj ankesën e ankuesit dhe të vërtetojë Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

Më 03/03/2020 ankuesi ka parashtrua një kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore me arsyetim se mbanë statusin e anëtarit të familjes së dëshmorit. Kërkesës i ka bashkangjitur Vendimin e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 05-03/360 të datës 01/12/2001

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet vërtetuar.

Kriteret se kur duhet të lëshohet masa e përkohshme përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kriteret janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: fumus boni iuris (propabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar = presupozimi i bazës së

mjaftueshme ligjore), dhe periculum in mora (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar.

Në lëndën në fjalë, paditësi/ankuesi nuk ka dëshmuar se mund të ndodhë dëmi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm ndaj të drejtës së pretenduar pronësore, nëse nuk lëshohet masa e sigurisë : veçanërisht, as me kërkesën e parë për masë të sigurimit, as me kërkesën e dytë për masë të sigurimit e as me ankesë ai nuk ka ofruar dokumente apo dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij, në mënyrë që të dëshmojnë probalitet mbi të drejtën e pretenduar , Kontrata mbi faljen e vitit 1962 është e pa nënshkruar dhe e pa vulosur, ndërsa prona kontestuese nuk është në shitje, sipas përgjigjes së AKP-së të datës 24.12.2019. Prandaj nuk ekziston rreziku i dëmit të menjëhershëm dhe të pariparueshëm.

Andaj, Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Kolegjit të Specializuar se nga paditësi nuk është paraqitur ndonjë rrethanë me anë të së cilës do të bëhej i besueshëm fakti se dëmi është i menjëhershëm dhe i pariparueshëm nëse nuk aprovohet kërkesa për masën e sigurisë.

Nga kjo shihet që në këtë periudhë, njësitë kadastrale të pronës së pretenduar të paditësit, nuk janë në shitje ose në procedurë të shitjes, andaj rrjedhimisht mund të konstatohet se aktualisht nuk ka rrezik për ndonjë dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm, nëse nuk caktohet masa e sigurimit e kërkuar nga ankuesi.

Kolegji i Apelit konstaton se në bazë të provave që ka ofruar ankuesi deri në këtë fazë të procedurës, nuk mund të merret ndonjë vendim tjetër nga ai që është marrë nga Kolegji i Specializuar dhe që është kundërshtuar nga paditësi.

Prandaj konstatimi i Kolegjit të Specializuar se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 61 të LDHP-së 06/L-086 për të caktuar masën e sigurisë është i saktë dhe i bazuar në ligj.

Për arsyet e lartë theksuara, Kolegji i Apelit e vërteton Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.



Ky aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejudikon zgjidhjen përfundimtare të padisë.

Nga sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Sipas nenit 8.1.5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin për Taksë Gjyqësore nga pagesa e taksave lirohen, "Familjet e viktimave civile të luftës".

Duke vlerësuar dokumentacionin e bashkangjitur kërkesës për lirim nga pagimi i taksës, Kryesuesi i Kolegjit të Apelit vlerëson se ankuesi i plotëson kriteret ligjore, në bazë të nenit të cekur më lartë të LPK-së, për tu liruar nga pagimi i taksës, pasi që ka vërtetuar që është anëtar i shoqatës të familjeve të viktimave civile të luftës.

Prandaj Kryesuesi i Kolegjit vendosi që të njëjtin të liroj nga pagesa e taksës gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 mars 2020.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_

